

## **RECOM Lobon për Mbledhjen e Një Million Nënshkrimeve Përkrahëse**

*Fushata në Kosovë ka filluar më 26 prill 2011 dhe ka përfunduar më 05 qershor 2011, ashtu sikurse ishte planifikuar në fillim.*

### **Përmbledhje**

Fushata për mbledhjen e nënshkrimeve në përkrahje të RECOM-it, Komisioni Regjional për Mbledhjen e Fakteve për Krimet e Luftës dhe Shkeljet e tjera Serioze të të Drejtave të Njeriut të Kryera në Territorin e Ish-Jugosllavisë në Periudhën 1991-2001, është një iniciativë e cila ka filluar më 26 prill 2011 dhe ka vazhduar për gjashtë javë, deri më 05 qershor 2011. Gjatë kësaj periudhe aktivistë të rinj nga Kosova, Serbia, Maqedonia, Mali i Zi, Kroacia, Bosnja-Hercegovina dhe Sllovenia, kanë dalë njëherësh në rrugë për të mbledhur një milion nënshkrime, me qëllim të përkrahjes së krijimit të Komisionit Rajonal RECOM. Në fund, nënshkrimet kanë pasur si qëllim t'i prezantohen qeverisë së secilit vend, duke u prezantuar si provë e mbështetjes nga shoqëria civile, në mënyrë që të bindin qveritë përkatëse të përkrahin këtë iniciativë duke nënshkruar peticionin, dhe të përkrahin themelimin e Komisionit të parë Rajonal RECOM. Misioni i RECOM-it do të jetë mbledhja e fakteve për krimet e luftës të kryera në Ish-Jugosllavi nga viti 1991 deri më 2001 dhe krijimi i një sistemi gjithëpërfshirës për arkivimin e dokumentacionit, i cili do të përfshijë edhe një vlerësim ekonomik të humbjeve, si rezultat i luftës. Komisioni Rajonal do të:

- Përpilojë një raport përfundimtar, i cili do të përbëhet nga: një listë e njerëzve të vrarë dhe të zhdukur, një listë e kampeve dhe pikave të tjera të arrestimeve dhe kontrolleve
- Përcaktojë fatin e 15,000 personave që janë ende të zhdukur ne gjithë rajonin, që përbën Ish-Jugosllavinë
- Ndërtojë solidaritetin mes viktimave të të gjitha grupeve etnike nga të gjitha vendet

- Kujdeset për viktimat dhe familjet e tyre me dinjitet

Është menduar që Komisioni të përfshijë popullsinë shumicë dhe pakicë, familjet dhe shoqatat e viktimave dhe personave të zhdukur, dhe të gjithë ata që kanë me etnitet identik me “autorët” kryesorë. Përfshirja e tyre flet për thellësinë dhe fushën në të cilën Komisioni ka për qëllim të shqyrtojë luftën. Nëpërmjet procesit të mbledhjes së fakteve për dëmet e luftës, sistemi i drejtësisë do të shqyrtohet nga afër në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Themelimi i Komisionit është i një rëndësie të veçantë për Kosovën, ku ende ka 1,821 persona të zhdukur, dhe ku nuk ekziston asnjë listë e detajizuar për viktimat e luftës. Kosova, gjithashtu, nuk është njohur, ende, nga dy vende të Ish Jugosllavisë, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, gjë që është duke minuar aftësinë e vendit për të ecur përpara, që prej përfundimit të luftës.

Më shumë se 500,000 njerëz nga i gjithë rajoni – mbi gjysma e targetit të synuar – kanë nënshkruar petitionin për RECOM-in, gjatë fushatës për mbledhjen e një million nënshkrimeve.

Nga të gjitha nënshkrimet e mbledhura, rreth 100,513 nënshkrime janë mbledhur në Kosovë, apo njëzet përqind e gjithë nënshkrimeve të mbledhura gjatë fushatës dhe 10 përqind të një million nënshkrimeve të synuara. Pjesëmarrja në Kosovë e ka tejkaluar pjesëmarrjen në Serbi, Slloveni, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Mal të Zi dhe Maqedoni. Individët që kanë refuzuar të nënshkruajnë petitionin e kanë perceptuar RECOM-in si një iniciativë “që ka ardhur nga Beogradi”. Por, edhe pse ka pasur një refuzim të vrazhdë të iniciativës së RECOM-it nga segmente të popullsisë, Kosova është i vetmi vend në rajon që arriti të mbledhë të gjitha nënshkrimet që kishte planifikuar. Në fakt, Kosova i tejkaloi pritjet duke mbledhur më shumë nënshkrime se sa kishte synuar në fillim.

**Tabelë**

Vendi	Shtetësia	Nënshkrimet
Të gjitha vendet	371432	371007
Bosnja dhe Hercegovina	66045	68652
Mali i Zi	27097	26841
Kroacia	15733	14340
Sërbia	148881	147688
Kosova	100513	100467
Sllovenia	4605	4427
Maqedonia	8558	8439

Të tjerë	0	135	
----------	---	-----	--

Përveç attributeve të dukshme që duhet t'i jepen organizatave përgjegjëse për mbledhjen e nënshkrimeve, si OJQ-ja Integra në Kosovë, informacioni me të dhënat e prezantuara më lart mund të jetë i dobishëm për kërkime dhe analiza të mundshme rreth ndërlidhjes së këtyre të dhënave, që nga përfundimi i konfliktit të dhunshëm, numrave të viktimave, zhvillimeve aktuale socio-politike, etj.

Tani që fushata ka përfunduar dhe shifrat janë llogaritur ka ardhur koha për rivlerësim. Mbledhja e nënshkrimeve do të vazhdojë, pafundësisht, deri sa të arrihet qëllimi. Përvec pikave për mbledhjen e nënshkrimeve, në të gjitha qytetet dhe fshatrat e vendeve të ish –Jugosllavisë, nënshkrimet do të mblidhen edhe “on line” – pra, në mënyrë elektronike. Megjithatë, fushata derë më derë nuk do të vazhdojë. Informata rreth fushatës do të jetë në dizpozicion dhe e gatshme dhe do t'i shpërndahet atyre që janë të interesuar.

### **Fushata e Avokimit për RECOM në Kosovë**

Gjatë fushatës avokuese, CRDP ka përdorur metoda gjithëpërfshirëse për të siguruar përkrahjen e popullatës së ndryshme në Kosovë. Qendra ka organizuar dhjetë takime me aktorë të shoqërisë civile dhe shërbyes publikë, nga komuna të ndryshme të Kosovës. Në to kanë marrë pjesë më shumë se tre qind burra dhe gra nga etni të ndryshme që jetojnë dhe veprojnë në Kosovë. Pjesëmarrësit në këto takime kanë ndarë pikpamjet e tyre për RECOM-in dhe kanë dhënë sygjerimet e tyre për këtë iniciativë. Pjesëmarrësit e kanë treguar përkrahjen e tyre nëpërmjet nënshkrimit të peticionit.

Në kuadër të RECOM-it, Kosova rangohet e dyta në rajon sa i përket numrit të OJQ-ve dhe individëve që e kanë nënshkruar deklaratën. Duke pasur parasysh madhësinë e Kosovës, fushata ishte një sukses i madh. Nënshkrimi i peticionit përkrahës u bë nga gra, të rinj, artistë dhe nga aktivistët më prominentë të të drejtave të njeriut, në vend. Njerëzit kanë nënshkruar si individë dhe si anëtarë të OJQ-ve, shoqatave të viktimave, shoqatave të veteranëve, organizatave mediale dhe komuniteteve të religjionit.

Megjithatë, jo çdokush në Kosovë e ka përkrahur RECOM-in. Nga nëntembëdhjetë grupe të Këshillit Koordinues të Shoqatave të Familjeve të Personave të Zhdukur, ende vetëm dy prej tyre e kanë përkrahur RECOM-in. Të gjitha grupet e tjera janë kundër iniciativës për Komisionin Rajonal. OJQ-ja Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (dhe nën degët e saj),

ka kundërshtuar krijimin e RECOM-it. Grupe të tjera të ekspertëve, të cilët as kanë qenë pro dhe as kundër RECOM-it, kanë ndikuar negativisht ndaj iniciativës me qëndrimin e tyre më shumë ambivalent se sa të qartë.

Opozita është edhe e vendosur edhe e guximshme. Më 29 prill 2011 – vetëm tre ditë pas lansimit të suksesshëm të RECOM-it në Kosovë – Këshilli Koordinues i Shoqatave të Familjeve të Personave të Zhdukur (një nga kundërshtarët më të zjarrtë të RECOM-it) ka lëshuar një deklaratë publike duke i kërkuar njerëzve të mos e përkrahin iniciativën e RECOM-it.

Shumë gazeta kosovare kanë publikuar deklaratën kundërshtuese dhe kanë paraqitur këtë përmbledhje të Këshillit Koordinues të Shoqatave të Familjeve të Personave të Zhdukur:

Këshilli Koordinues i Shoqatave të Familjeve të Personave të Zhdukur, ka reaguar ndaj fushatës për mbledhjen e nënshkrimeve në disa qytete të Republikës së Kosovës dhe rajon, duke u bazuar në iniciativën e “Fondit Humanitar të Beogradit” , e cila ka raportuar gjoja për „nevojën për gjykimet rreth krimeve të luftës në Ish-Jugosllavi”.

“Ashtu si më parë, shërbëtorët e Beogradit po manipulojnë popullin, veçanërisht familjet e të zhdukurve, duke deklaruar rrejshëm se iniciativa serbe është përkrahur nga shumica e shqiptarëve të Kosovës, veçanërisht familjet e viktimave të konfliktit të fundit në Kosovë” [e vënë në dukje në një komunikatë të këtij Këshilli].

Komunikata thotë se nga 25 shoqata të shiptarëve të zhdukur që veprojnë në Kosovë vetëm dy individë të cilët gjoja se janë duke udhëhequr shoqata të tilla përkrahën punën e Fondit Humanitar Serb. ).<sup>1</sup>

Deklarata ka krijuar konfuzion tek ata që prezantohej një perspektivë plotësisht e re për RECOM-in.

Konfuzioni bëri që disa të ngrejnë pyetjen nga erdhi kjo iniciativë, e cila vë në pozitë qeverinë se çfarë duhet të marrë në të dhe nëse ata do ta përkrahin ose jo një iniciativë të tillë. Konfuzioni dhe dykuptimësia u reflektua në masë të madhe në terren kur vullnetarët kanë dalë për të marrë nënshkrimet derë më derë apo kur e kanë ftuar popullin të vizitojë standat e ngritura për shpërndarjen e informacionit dhe mbledhjen e nënshkrimeve.

<sup>1</sup> <http://www.ekonomisti.net/artikulli/1/0/9999/familjet-e-te-zhdukurve-reagojne-ndaj-fushates-komra/>

<http://shqip.time.mk/read/0921da7c93/fb880c2a0/index.html>

Sa i përket mbledhjes së nënshkrimeve, përgjigjia në shumë qytete/rajone të Kosovës ishte e ndryshme. Opinionet rreth krijimit të Komisionit Rajonal RECOM ka variuar nga kundërshtimi i plotë në përkrahje të plotë. Është e rëndësishme që të lihen viktimat të flasin dhe të sigurohemi se zërat e tyre dëgjoen, pavarësisht nëse ata e japin apo jo nënshkrimin e tyre. Kritikën dhe ankesat e tyre për Komisionin Rajonal mund të jenë të dobishme, për të rritur efikasitetin, për të qenë më shumë solidarë dhe më gjithëpërfshirës rreth iniciativës.

### **Mendime të Ndryshme për RECOM-in nga Gjithë Kosova**

Një nga dyshimet më të mëdha, të shprehura në të gjithë Kosovën, ka qenë nëse kjo iniciativë dhe Komisioni Rajonal janë krijuar shumë vonë. Familjet dhe shoqatat e viktimave ndjehen si të injoruar dhe besojnë se ata nuk do të përfitojnë duke u marrë me konfliktin pas dymbëdhjetë viteve të përfundimit të tij. Në një vëzhgim nga Peja kemi kuptuar se disa prej atyre që nuk e kanë nënshkruar peticionin dhe e kanë konsideruar iniciativën “si të vonuar” ishin martirët dhe personat e zhdukur të cilët thanë se ishin ende të lënduar nga ajo që ka ndodhur. Ashtu siç ka thënë Marigona Sheremeti: “kjo ka qenë zgjedhja e tyre dhe ne nuk mund t’i detyrojmë ata të nënshkruajnë”. Ajo ka të drejtë, por, dhimbja aktuale e tyre nga konflikti i kaluar është dëshmi për domosdoshmërinë e krijimit të Komisionit, i cili do t’i ndihmojë ata të merren me të kaluarën dhe të lehtësojnë dhimbjen. Ata, gjithashtu, mendojnë se askush nuk është kujdesur për personat e zhdukur para dymbëdhjetë viteve, kështu që, tani është përfundimisht shumë vonë. Ata flasin sikur mbledhja e informacioneve për personat e zhdukur të jetë një mundësi e humbur.

Nëse duhet të mësojmë nga kjo përvojë, programi për mbledhjen e nënshkrimeve dhe shpërndarjes së informacionit duhet të rishikohet, me qëllim që të jepen shembuj që dëshmojnë se komisionet e së vërtetës dhe proceset e drejtësisë kalimtare marrin kohë. Duke vepruar kështu, mund të bindim ata që e kanë kundërshtuar Komisionin se sa i dobishëm është ai dhe t’i ndihmojmë ata të kuptojnë kompleksitetet e procesit. Komisionet dhe tribunalet janë krijuar në kohën e duhur dhe kur palët e konfliktit kanë shprehur dëshirën për të ecur përpara. Për më tepër, nuk mund të egzistojnë kapacitete që do të mund të merreshin me sigurimin e fakteve për një luftë, menjëherë pas përfundimit të saj, duke pasur parasysh dëmet në infrastrukturë dhe ekonomi, të cilat kërkojnë kujdes të menjëhershëm.

Kritikët e tjerë të iniciativës e bazojnë skepticizmin e tyre në përfshirjen e Serbisë në Komision. Kemi veçuar mendimin e z. Jahir Bejta, nga Gllogovci, për RECOM-in:

“Çka është inisiativa e RECOM-it, na lini pak të bisedojmë rreth propozimit të Statutit. Ky statut është hartuar në një mënyrë misterioze, me qëllim që Serbia të mos jetë përgjegjëse dhe të mos paguajë borxhin ndaj gjithë rajonit të Ballkanit, veçanërisht borxhin që i’a ka Kosovës”.

Atmosfera e përgjithshme, për Komisionin Rajonal, në Gllogovc është negative. Disa pjesëmarrës kanë theksuar se, njerëzit që e kanë nënshkruar peticionin nuk e kanë ditur se çfarë kanë nënshkruar. Ata, gjithashtu, janë dyshues rreth procesit se si merret informacioni, për të cilin ata mendojnë se po eksploatohen viktimat.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile te komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në Ferizaj, të cilët kanë marrë pjesë në diktumime, e vlerësojnë Komisionin sit ë dobishëm për të gjithë, përfshi komunitetet pakicë në gjithë rajonin. Hajrush Xhaferi ka bërë një observim të rëndësishëm rreth çështjes së mbrojtjes së dëshmitarëve dhe sigurinë e këtyre viktimave, veçanërisht viktimave nga minoriteti, të cilët kanë kontribuar në komision. Ai rekomandon që këta viktima të kenë më shumë siguri personale, pasi nuk ka mbrojtje apo statute zyrtare për dëshmitarët: “Unë i bëj thirrje të gjithëve të jenë të kujdesshëm me veprimet e tyre, sepse ne e dimë se ka shumë dëshmitarë që nuk shkojnë në Tribunalin e Hagës për shkak të presioneve dhe kërcënimeve. Këto janë gjëra që ju duhet ti dini”. Shpagimi është një brengë e madhe dhe mund të jetë një pengesë për sistemin e sigurisë dhe i njëjti duhet të zhduket që RECOM-i të arrijë qëllimin e vet. Pavarësisht këtyre rreziqeve, ka respodentë nga komuniteti minoritar të cilët janë të gatshëm të nënshkruajnë dhe përkrahin Komisionin. Ata shpresojnë se, inisiativa do t’i japë përgjigje dhe informata për anëtarët e zhdukur të familjeve të tyre. Në qytetin e Gjakovës shumë njerëz kanë hezitur të nënshkruajnë peticionin dhe kanë heshtur duke mos i thënë arsyet, pse?

Flaka Uka ka ndarë një ngjarje për një anëtar të komunitetit Rom, në takimin që patëm në Pejë, më 12 maj 2011: “Ne kemi vendet ku njerëzit e përkrahin inisiativën dhe nënshkruajnë. Unë dëshiroj të përmend një rast, kur një anëtar i komunitetit Rom më tregoi se ai kishte pesë djem të zhdukur në luftën e fundit në Kosovë. Ai më kapi për dore dhe më falenderoi që kam gjetur kohë dhe e kam vizituar atë. Ai ishte rreth të gjashtë dhjetave dhe jetonte vetëm me gruan. Ai nënshkroi për vete dhe për gruan.” Veprimi i këtij burri rom e përforcon bindshëm nocionin e solidaritetit. Shpresa e tij mund të inspirojë të tjerët të komunikojnë dhe të fillojnë të merren me të kaluarën duke përkrahur RECOM-in.

Mendimi për RECOM-in në Mitrovicë ka qenë përgjithësisht përkrahës, me disa shqetësime kryesore. Rexhep Lushta thekson rëndësinë e dëshmimeve, pasi ata që fshehin krimin ata pajtohen me të. Ai beson se edhe pse mund të jetë e pamundshme të zgjidhet gjithçka, ata mund të informojnë viktimat rreth procesit të kërkimit të së vërtetës. Ata mund të dëshmojnë dhe të mos fajësojnë askënd. Ai e sheh RECOM-in si një mënyrë për të ndihmuar viktimat të gjejnë

rehati dhe të nxjerrin në pah të vërtetën. Në takimin që është mbajtur në Mitrovicë një respondent serb ka shfaqur përkrahjen e tij: “Çfarë dëgjova sot është mirë dhe i shërben inisiativës për të gjitha kombet në Ballkan. Ka ardhur koha të jemi të civilizuar. Unë jam një nga fatlumët që nuk e kanë përjetuar konfliktin e fundit në ish-Jugosllavi. Do të ishte më mirë që kjo të mos ishte sot temë e ditës. Unë shpresoj se kjo inisiativë do të jetë e suksesshme dhe e ofroj ndihmën time në gjithçka. Megjithatë, une e kam një pyetje për statutin, konkretisht në lidhje me mandatin e komisionit, për periudhën 1991-2001?<sup>2</sup> Shqetësimi ishte se nëse periudha pas vitit 2001 nuk përfshihej në RECOM, viktimat që i kanë humbur anëtarët e familjeve të tyre gjatë asaj periudhe nuk do të nënshkruanin petitionin dhe nuk do të përkrahnin atë. Periudha që mbulon mandati është një çështje mjaft e ndjeshme, pasi disa familjeve serbe i kishin kidnapuar fëmijët edhe pas vitit 2001.

Në rajonin e Anamoravës, në Kosovën Lindore, veçanërisht në qytetin e Gjilanit, numri i nënshkrimeve të mbledhura ka qenë shumë i vogël pasi ajo zonë nuk ka pasur shkatërrime të mëdha, ashtu sikurse pjesët qendrore, veriore dhe perëndimore të Kosovës. Numrat e ulët në Gjilan mund të shpjegohen edhe me faktin se numri i viktimave dhe personave të zhdukur në këtë rajon është më i vogël. Duke pasur parasysh këtë informacion, mund të mendohet se popullata e kësaj zone mund të ndjehet më pak e ndjeshme dhe solidare me ata që janë afektuar më shumë nga konflikti.

Përvojat dhe brengat e të gjithë pjesëmarrësve, që kanë dalë nga takimet përreth Kosovës, nxjerrin në pah më së miri mendimet dhe opinionet për Komisionin Rajonal. Askush nuk është gabim apo ka të drejtë; secili ka mendimin e vet. Shumica e njerëzve ka dhënë arsyet për mos nënshkrimin e petitionit dhe brengat personale rreth motiveve të RECOM-it. Ata persona që e kanë përkrahur kanë kërkuar krijimin e Komisionit, në mënyrë që vuajtjet e atyre familjeve dhe personave të mund të zbuten dhe familjet e viktimave dhe personave të zhdukur të informohen dhe të qetësohen sado pak.

### **Brengat Për të Ardhmen e RECOM-it**

Shënimet nga takimet lobuese dhe avokuese përreth Kosovës, ku është diskutuar krijimi i RECOM-it dhe është vlerësuar mbledhja e nënshkrimeve, theksojnë përparësitë dhe dobësitë e Kolacionit Rajonal duke u bazuar në mbledhjen e nënshkrimeve përkrahëse. Gjithashtu, ka disa brenga solide, të cilat mund të fillojnë të zgjidhen sapo që procesi të hyjë në rrjedhë normale të zhvillimit. Për shembull, të sigurohet një transparencë dhe llogaridhënie më e mirë, aktivistët

---

<sup>2</sup> ‘Pyetja ishte nëse RECOM-i do të përfshinte në Mandati I RECOM-it edhe periudhën pas 2001-shit’?

që kanë mbledhur nënshkrime duhet të nënshkruajnë një kontartë për tu siguruar se nuk janë mbledhur nënshkrime të dyfishta dhe fallse. Nëse ndodh diçka e tillë do të kishim një shkatërrim të fushatës për mbledhjen e një million nënshkrimeve. Duhet të merren masa shtesë që të garantohet se nuk do të ketë problem me nënshkrime të dyfishta apo fallse dhe që të gjitha nënshkrimet të jenë të vlefshme. Gjithashtu, përkrahësit e RECOM-it do të publikojnë informacionin duke identifikuar grupet kryesore demografike, veçanërisht grup-moshat e veçanta. A do të ketë një moshë minimale për nënshkrimin e peticionit? Nëse po, si do të përcaktohet mosha dhe çfarë justifikimi ka për të?

Në të gjitha takimet ka disa komente të cilat theksojnë shqetësimin për Mandatin e Komisionit, duke u fokusuar vetëm në periudhën 1991-2001. Disa mendojnë se mandati duhet të zgjasë përtej vitit 2001 dhe disa mendojnë se ai duhet të fillojë para vitit 1991. Shqetësimet e tyre mund të justifikohen vetëm nëse RECOM-i bëhet një komision rajonal gjithëpërfshirës i së vertetës. Megjithatë, në vend që të ngarkohen me çdo detaj, përkrahësit e Komisionit duhet të adresojnë këtë shqetësim dhe të theksojnë faktin se periudha më e dhunshme në rajon ka qenë dekada ndërmjet viteve 1991 dhe 2001, prandaj dhe kjo periudhë është në fokus të Komisionit Rajonal. Mandati thekson qartë se nuk ka për qëllim të injorojë periudhat e dhunës dhe persekutimit para vitit 1991 dhe pas vitit 2001, por se objektiva fillestare e tij është të merret kryesisht me këtë periudhë, kur kanë ndodhur shumica e krimeve më të rënda të luftës dhe krimet kundër njerëzimit. Ata duhet të rirforcojnë përkushtimin e tyre për ta bërë RECOM-in një inisiativë gjithëpërfshirëse dhe të shpjegojnë se procesi kërkon kohë deri sa të mund të konsiderohet si sukses.

## **Konkluzion**

Pavarësisht përkrahjes dhe kritikave të shumta që patën vullnetarët në terren, si dhe debateve dhe propagandës kontradiktore në media për inisiativën e RECOM-it dhe fushatës së saj për mbledhjen e një million nënshkrimeve përkrahëse, përvoja në Kosovë ka qenë një sukses i gjithëmbarshtëm. Z. Agani, Ministër i Shëndetsisë, në Qeverinë e Kosovës, ka theksuar se: "Kjo inisiativë dhe Komisioni i saj Rajonal janë mënyra e vetme për të tejkaluar barrierat e krijuara prej politikës për sa i përket krimeve të luftës". Ai, gjithashtu, shprehu bindjen se krijimi i Komisionit do të përkrahet edhe nga anëtarët e Parlamentit të Kosovës".

Në një periudhë të shkurtër, 100,513 anëtarë të shoqërisë kosovare shprehën angazhimin e tyre për të vendosur drejtësnëi dhe për t'u marrë me të kaluarën duke i dhënë nënshkrimet e tyre në përkrahje të RECOM-it. Arritja e Kosovës në këtë pikë është mbresëlënëse duke pasur parasysh përmasat e saj gjeografike në raport me vendet e tjera të rajonit, të cilat po marrin pjesë në fushatën për mbledhjen e nënshkrimeve.